



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.11.2021

#### Dokument parlamentar

#### Komision përgjegjës

### R A P O R T

#### PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

#### *(SHQYRTIMI NË PARIM)*

#### **I. Hyrje.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në 11 mbledhje, të zhvilluara në datat 1, 2, 3, 5, 8, 9, 10 dhe 11 nëntor 2020, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat është komisioni përgjegjës për shqyrtimin e tij. Shqyrtimi i këtij projektligji bëhet sipas procedurave të përcaktuara në nenet 78-84 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore, për këtë projektligj, znj. Blerina Gjylameti dhe znj. Pranvera Resulaj.

Projektbuxheti, si çdo vit, u shqyrtua sipas një kalendari të posaçëm pune, të koordinuar me komisionet e tjera të Kuvendit. Komisioni shqyrtoi politikat dhe treguesit e përgjithshëm të projektbuxhetit, si dhe analizoi në detaj pjesët e veçanta të tij, si të ardhurat, shpenzimet, defiçitin buxhetor e borxhin publik.

Në të gjitha mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm Ministrja e Financave dhe drejtues të stafit të kësaj ministrie.

Në një mbledhje të posaçme, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me drejtuesit e Bankës së Shqipërisë, për të marrë opinionin e këtij institucioni mbi projektbuxhetin.

Gjithashtu, Komisioni zhvilloi seanca dëgjimore me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministren e Arsimit dhe Sportit; Ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministrin e Brendshëm; si dhe Ministrin e Shtetit për Rindërtimin

dhe Programin e Reformave; për t'u njohur më në detaj dhe për të analizuar më në thellësi projektbuxhetin në këta sektorë të rëndësishëm të ekonomisë.

Komisioni zhvilloi edhe një seancë dëgjimore me grupet e interesit, si Shoqatën për Autonomi Vendore dhe Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, si dhe disa drejtues të bashkive në vend, në të cilën u njoh me kërkesat e tyre për disa ndryshime në projektbuxhet.

## **II. Baza ligjore.**

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin mbështetur në:

- Nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 29 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

## **III. Kuadri i politikave mbi të cilat bazohet projektbuxheti 2022.**

Politikat, treguesit dhe objektivat e projektbuxhetit 2022 mbështeten në:

- Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022;
- Kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm 2022-2024;
- Programin e Qeverisë;
- Politikat dhe prioritetet e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë;
- Ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore përkatëse etj.

Projektbuxheti ka në themel objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm për tri vitet në vijim. Ky dokument synon ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimin e klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimin sa shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies së Bashkimit Europian. Këto synime të kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm parashikohen të realizohen nëpërmjet zbatimit të disa objektivave, siç janë:

- Synimi i një trajktoreje rënëse të borxhit publik, duke targetuar si objektiv operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit prej vitit buxhetor 2024 e në vijim.
- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe, mundësisht, mbi nivelin 4.5 përqind të PBB mesatarisht çdo vit.
- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektiv themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3 përqind dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizmin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare.

- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këto objektiva themelore përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal, brenda të cilave përcaktohen projeksionet e detajuara.

Politikat dhe treguesit e projektbuxhetit mbështeten në trendin e zhvillimit të ekonomisë së vendit në vite, zhvillimet dhe politikat ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme për vitin 2022, si dhe pritshmëritë për zhvillimin afatmesëm.

- *Projektbuxheti 2022 paraqitet si pjesë e PBA 2022-2024.*

Që prej vitit 2015, projektbuxheti vjetor paraqitet si pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, duke përcaktuar dhe harmonizuar politikat, prioritetet dhe treguesit për vitin e ardhshëm me ato të periudhës afatmesme. Projektbuxheti 2022 paraqitet si pjesë e PBA 2022-2024, e cila pasqyron kufijtë maksimalë të shpenzimeve buxhetore për çdo ministri e institucion, të detajuar edhe sipas programeve buxhetore për secilin prej viteve të periudhës afatmesme.

- *Projektbuxheti 2022 mbështetet në vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare.*

Projektbuxheti mban në konsideratë vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si Komisioni Europian, FMN e Banka Botërore, si dhe të agjencive ndërkombëtare që mbikëqyrin ekonominë e vendit tonë. Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

*Komisioni Europian* ka vlerësuar se Shqipëria ka bërë disa përparime dhe është e përgatitur në zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Shqipëria shënoi rritje ekonomike, papunësia u zvogëlua, eksportet u rritën në mënyrë të qëndrueshme. Bankat vazhduan të ulnin numrin e kredive me probleme dhe përdorimin e monedhës së huaj. Sektori bankar mbeti i qëndrueshëm. Hapat drejt zhvillimit të tregut financiar janë marrë. Progresi në zbatimin e reformës gjithëpërfshirëse të drejtësisë pritet të kontribuojë në forcimin e mjedisit të biznesit dhe tërheqjen e investimeve. Komisioni Europian jep edhe disa rekomandime për masat që duhet të ndërmerren në drejtim të uljes së borxhit publik, forcimit të mjedisit të biznesit, përmirësimeve në tregun e punës etj.

*Fondi Monetar Ndërkombëtar* ka vlerësuar se ekonomia e Shqipërisë ka qenë e qëndrueshme pas tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë. Politikat luajtën rol kyç në ruajtjen e jetëve dhe mjeteve të jetesës, duke hapur rrugë rimëkëmbjes ekonomike.

Pas një periudhe kontraktimi me 4 për qind në vitin 2020, ekonomia po ngrihet fuqishëm, me rritje të parashikuar prej 7.8 për qind në vitin 2021, duke u mbështetur nga politika fiskale e monetare mbështetëse, rindërtimi, pakësimi i kufizimeve të lëvizjes, prodhimi i lartë i energjisë elektrike, si

rezultat i kushteve të mira të motit në 6-mujorin e parë 2021, si dhe sezoni turistik relativisht i mirë.

Sfidat kryesore të politikës fiskale janë investimi me efikasitet tek njerëzit dhe ekonomia, si dhe ulja e deficitit fiskal dhe borxhit publik.

*Banka Borërore* ka vlerësuar se rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë, në vitin 2021, është më e fortë se sa pritej, pasi turizmi, ndërtimet dhe prodhimet nxjerrëse u rikthyen, si dhe investimet private, konsumi dhe shpenzimet publike u rritën. Politikat makroekonomike kanë mbështetur rimëkëmbjen. Një prioritet kyç i reformës afatmesme është rritja e mbledhjes së të ardhurave dhe arritja e konsolidimit fiskal, duke krijuar hapësirë për rritjen e shpenzimeve.

#### **IV. Opinioni i Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin.**

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë paraqiti opinionin e këtij institucioni për projektbuxhetin e vitit 2022. Në opinionin e tij, Guvernatori analizoi kahun dhe efektin e politikës fiskale në ekonomi, huamarrjen publike dhe ndikimin e saj në tregjet e brendshme financiare, si dhe rritjen e efektivitetit e të qëndrueshmërisë së financave publike.

*Duke analizuar kahun dhe efektin e politikës fiskale në ekonomi*, Guvernatori theksoi se projektbuxheti i vitit 2022 merr jetë në kontekstin e një procesi rimëkëmbjeje të ekonomisë shqiptare pas goditjes së tërmetit dhe pandemisë, si dhe sfidave afatmesme e afatgjata të zhvillimit të vendit, që kemi përpara.

Viti 2021, megjithë goditjet dhe sfidat, u karakterizua nga normat e larta të rritjes gjatë gjysmës së parë të vitit, rikuperimi i pjesshëm i treguesve të tregut të punës, përmirësimi gradual i bilanceve financiare të sektorit privat, stabiliteti i inflacionit dhe kursit të këmbimit, si dhe kreditimi në rritje i sektorit privat. Vëllimi i prodhimit ka kaluar nivelin që kishte para tërmetit dhe pandemisë.

Politikat stimuluuese fiskale e monetare garantuan stabilitetin financiar e monetar të vendit, nxitën kreditimin e aktivitetit ekonomik me kosto të ulët dhe lehtësuan barrën financiare të sektorit privat.

Në këto kushte, për të pasur një perspektivë pozitive të zhvillimit të vendit, politikat ekonomike duhet të orientohen drejt normalizimit, që do të thotë konsolidim fiskal i mbështetur nga tërheqja graduale e stimullit monetar. Kjo politikë do të ofrojë mbështetje për rimëkëmbjen ekonomike dhe zbutjen e rreziqeve fiskale nga rritja e borxhit publik.

*Lidhur me projektbuxhetin e vitit 2022*, Guvernatori vlerësoi se:

*Së pari*, projeksionet makroekonomike që konturojnë projektbuxhetin janë realiste, mbështetur edhe nga efekti pozitiv i rritjes së formalizimit të ekonomisë. Për të arritur këto projeksione, Guvernatori paraqiti disa sugjerime lidhur me:

- Ndjekjen e vazhdueshme nga autoritetet fiskale të ecurisë së të ardhurave;
- Zbatimin në kohë të masave për formalizimin e ekonomisë;
- Përfundimin dhe zbatimin sa më shpejt të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave.

*Së dyti*, Banka e Shqipërisë mirëpret konsolidimin fiskal gjatë vitit 2022, shpejtësia e të cilit kushtëzohet nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe përfundimi i procesit të rindërtimit. Në këtë kuadër, Guvernatori paraqiti disa sugjerime lidhur me:

- Përfshirjen në projektbuxhet të dispozitave që mundësojnë përshpejtimin e ritmit të konsolidimit fiskal gjatë vitit 2022, në rast se të ardhurat buxhetore rezultojnë më të mëdha se parashikimet apo në rast se nevoja për subvencionimin e importeve të energjisë elektrike rezulton më e ulët se vlerësimi aktual;
- Rishikimin e nenit 7 të projektligjit, duke mundësuar që të ardhurat në formë granti, me destinacion financimin e rindërtimit të dëmtimeve të tërmetit, të përdoren për reduktimin e borxhit publik;
- Përshpejtimin e ritmit të konsolidimit fiskal në horizontin afatmesëm dhe afatgjatë;
- Konsolidimi fiskal të bazohet më shumë në rritjen e të ardhurave se në shkurtimin e shpenzimeve.

*Së treti*, Banka e Shqipërisë inkurajon rritjen e investimeve kapitale në strukturën e buxhetit. Për këtë qëllim, Guvernatori sugjeroi se:

- Disiplinimi i shpenzimeve korrente dhe rritja e qëndrueshme e bazës së të ardhurave do të krijojnë premisa për ruajtjen e hapësirave fiskale për investime publike, edhe në prani të konsolidimit fiskal;
- Procesi i përzgjedhjes së projekteve të investimeve mund të përmirësohet më tej, nëpërmjet adoptimit të një strukture formale të vlerësimit të rentabilitetit të tyre në kohë.

*Duke analizuar huamarrjen publike dhe ndikimin e saj në tregjet e brendshme financiare*, Guvernatori theksoi se:

Projektbuxheti i vitit 2022 parashikon një deficit buxhetor prej rreth 101 miliardë lekësh ose 5.4 për qind të PBB. Gjysma e këtij deficiti buxhetor do të financohet nga huamarrja e brendshme dhe gjysma tjetër nga huamarrja e huaj.

Financimi në tregun e brendshëm do të sigurohet nga emetimi i letrave me vlerë. Financimi i huaj prej 51 miliardë lekësh, do të sigurohet nga:

- 25 miliardë lekë nga projektet e mbuluara nga financimi i huaj;
- 17.5 miliardë lekë nga mbështetja buxhetore e partnerëve ndërkombëtarë;
- 8.5 miliardë lekë nga emetimi i eurobondit në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2021.

Eurobondi, i cili parashikohet në vlerën 700 milionë euro ose 85 miliardë lekë do të përdoret si më poshtë:

- 34.1 miliardë lekë për mbulimin e pagesave të borxhit të huaj gjatë vitit 2021;
- 42.5 miliardë lekë për mbulimin e pagesave të borxhit të huaj gjatë vitit 2022;

- 8.5 miliardë lekë për financimin e deficitit buxhetor gjatë vitit 2022.

Në mungesë të eurobondit, qeveria do të duhej të ulte në një masë korresponduese shpenzimet e planifikuara gjatë periudhës afatmesme 2021-2022 ose të rriste huamarrjen në tregun e brendshëm.

Banka e Shqipërisë vlerëson se ky plan financimi është i arsyeshëm, pasi ndihmon në ruajtjen e një niveli të qëndrueshëm të normave të interesit në tregun e brendshëm dhe krijon hapësirë për kreditimin e sektorit privat.

Për periudhën afatmesme dhe afatgjatë, Banka e Shqipërisë gjykon se struktura e financimit të deficitit dhe borxhit publik duhet të synojë një mbështetje më të madhe në tregjet dhe monedhën vendase, për të reduktuar rrezikun e rritjes së normave të interesit dhe luhatjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë sugjeron:

- *Së pari*, rishikimin e dispozitave të parashikuara në nenin 10 të projektligjit, të cilat e kufizojnë huamarrjen në tregjet e brendshme financiare, të destinuar për financimin e deficitit buxhetor, në nivelin maksimal prej 50 miliardë lekësh dhe e reduktojnë këtë huamarrje për maksimalisht gjysmën e vlerës së të ardhurave të mundshme nga privatizimi gjatë vitit;
- *Së dyti*, zgjerimin dhe diversifikimin e mëtejshëm të bazës së investitorëve në tregun e brendshëm;
- *Së treti*, reduktimin e borxhit të huaj në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, duke sjellë reduktimin e borxhit publik.

Në përfundim të fjalës së tij, Guvernatori paraqiti disa sugjerime në ndihmë të *rritjes së qëndrueshmërisë afatgjatë dhe efektivitetit të financave publike*, siç janë përmirësimet në skemat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe në administrimin e programeve të partneritetit publik privat, si dhe shpërndarjen më të mirë të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit.

## **V. Përmbajtja e projektligjit.**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2022” pasqyron një informacion të detajuar mbi treguesit kryesorë të buxhetit për vitin 2022, siç janë të ardhurat, shpenzimet, deficitin buxhetor dhe financimi i tij. Ky informacion paraqitet për buxhetin e shtetit, buxhetin vendor dhe fondet speciale. Gjithashtu, ai përcakton rregullat për përdorimin e fondeve buxhetore. Projektligji shoqërohet me një set tabelash, ku treguesit pasqyrohen në total dhe të detajuar sipas ministrive e institucioneve, programeve e zërave buxhetorë.

Projektligji shoqërohet me relacionin shpjegues, ku analizohet në mënyrë të hollësishme realizimi i treguesve makroekonomikë e fiskalë për vitin 2021 dhe parashikimet për vitin 2022 e periudhën afatmesme 2022-2024. Raporti përmban edhe një analizë të hollësishme për buxhetin e njësisive të qeverisjes qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore, si dhe të dhe fondeve speciale.

## **VI. Diskutimi në Komision.**

Në mbledhjet e Komisionit paraqitën prezantime dhe iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministrja e Arsimit dhe Sportit; Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministri i Brendshëm; Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave; Guvernatori i Bankës së Shqipërisë si dhe drejtues të tjerë të ministrive të ftuara për t'u dëgjuar.

Znj. Blerina Gjylameti dhe znj. Pranvera Resulaj, relatore të projektligjit, paraqitën opinionin e tyre për projektbuxhetin në tërësi, treguesit makroekonomikë e fiskalë për vitet 2021, 2022 dhe periudhën afatmesme deri në vitin 2024, të ardhurat, shpenzimet, deficitin buxhetor dhe borxhin publik.

Në mbledhjet e Komisionit deputetët paraqitën shumë pyetje e diskutime. Shumica e anëtarëve të Komisionit mbështetën vlerësimin e bërë nga relatorët për realizimin e buxhetit të vitit aktual, projektbuxhetin vjetor e afatmesëm, si dhe politikat respektive, si më poshtë:

### **VI.1. Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2021.**

Gjatë periudhës 10-mujore të vitit 2021 aktiviteti ekonomik në vend arriti një rikuperim të shpejtë dhe e tillë parashikohet ecuria deri në fund të vitit. Pritshmëritë janë që rritja ekonomike për vitin 2021 të jetë 7.6 për qind.

Faktorët që ndikuan pozitivisht në rikuperimin e ekonomisë ishin reduktimi i kufizimeve që solli pandemia, përmirësimi i besimit të familjeve e bizneseve, si dhe stimuli ekonomik fiskal e monetar. Rritja e vaksinimit, dërgesat e emigrantëve, rritja e kredisë dhe rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik në partnerët tregtarë rritën ndjeshmërinë e konsumatorit dhe biznesit, si dhe kërkesën e brendshme.

Rritja e kërkesës agregate u pasqyrua nëpërmjet rritjes së konsumit dhe investimeve private, rritjes së shpenzimeve buxhetore, si dhe zgjerimit të eksportit të mallrave e shërbimeve. Sektorët që ndikuan më shumë në rritjen ekonomike ishin ndërtimi, industria dhe shërbimet.

Përmirësimi i aktivitetit ekonomik u pasqyrua në tregun e punës, ku norma e papunësisë zbriti nga 12.2 për qind në vitin 2020, në 11.4 për qind në vitin 2021. Përmirësimi i mëtejshëm i treguesve të punësimit kërkon më shumë kohë dhe mbështetje me stimuj makroekonomikë.

*Politikat fiskale* siguruan mbështetje për rimëkëmbjen ekonomike.

*Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit*, për vitin 2021, parashikohet të jenë rreth 498 miliardë lekë, duke u rritur me rreth 72 miliardë lekë ose 16.9 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Këto të ardhura përbëjnë 28.1 për qind të PBB, nga 26.6 për qind e PBB që ishin një vit më parë. Sipas zërave, pritshmëritë për rritjen e të ardhurave të vitit 2021 janë si më poshtë:

- Të ardhurat nga tatimet dhe doganat rriten me 49 miliardë lekë ose 17.6 pikë përqindje. Këto të ardhura përbëjnë rreth 65.9 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit;
- Të ardhurat nga fondet speciale rriten me 7.3 miliardë lekë ose 7.5 pikë përqindje. Këto të ardhura përbëjnë rreth 21.1 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit;
- Të ardhurat nga pushteti vendor rriten me 4 miliardë lekë ose 18.6 pikë përqindje. Këto të ardhura përbëjnë rreth 5.2 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit;
- Të ardhurat jotatimore rriten me 2.6 miliardë lekë ose 14 pikë përqindje. Këto të ardhura përbëjnë rreth 4.3 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Në rritjen e të ardhurave kanë ndikuar pozitivisht këta faktorë:

- rigjallërimi i ekonomisë në vitin 2021, sidomos i sektorit privat;
- rritja e investimeve shtetërore në përgjithësi dhe në kuadrin e rindërtimit në veçanti;
- rritja e volumit të eksport-importeve, turizmit dhe prodhimit, e shoqëruar kjo me rritjen e kërkesës së brendshme;
- përmirësimet në luftën kundër informalitetit dhe evazionit fiskal.

*Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit*, për vitin 2021, parashikohen në nivelin 619 miliardë lekë, duke u rritur me 82 miliardë lekë ose 15.3 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Këto shpenzime përbëjnë 35 për qind të PBB, nga 33.2 për qind e PBB që ishin një vit më parë. Sipas zërave, realizimi i shpenzimeve parashikohet si më poshtë:

- *Shpenzimet korrente* rriten me 47.5 miliardë lekë ose 11.3 pikë përqindje. Këto shpenzime përbëjnë 75.8 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit;
- Shpenzimet kapitale rriten me 28.3 miliardë lekë ose 27.9 pikë përqindje. Këto shpenzime përbëjnë rreth 21 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.

*Deficiti buxhetor* parashikohet të jetë në nivelin 6.8 për qind të PBB, duke ruajtur nivelin e vitit të mëparshëm.

*Borxhi publik* parashikohet në nivelin 80.6 për qind e PBB.



*Politikat monetare* ishin stimuluese, duke mbështetur rritjen ekonomike dhe kthimin e inflacionit në objektiv.

Stimuli monetar ka siguruar një mjedis financiar të favorshëm për rritjen e ekonomisë dhe kthimin e inflacionit në objektiv. Inflacioni parashikohet të arrijë nivelin mesatar prej 2.2 për qind në vitin 2021, nga 1.6 për qind që ishte një vit më parë. Tregjet financiare funksionojnë normalisht, kostot e financimit të sektorit publik dhe privat janë të ulëta dhe bilancet e sektorit bankar paraqiten të shëndetshme. Kushtet e financimit mbeten të përshtatshme për nxitjen e kërkesës agregate, dhe pasqyrojnë një transmetim të mirë të stimulit monetar.

Kredia bankare vijoi të jetë një burim i qëndrueshëm financimi për ekonominë, duke pasqyruar kushtet e favorshme të financimit, rritjen e kërkesës dhe përjasjen pozitive të bankave ndaj kreditimit. Vëllimi i kredisë për sektorin privat u rrit mesatarisht me 8.4% në muajt korrik e gusht. Rritja e kredisë ka financuar zgjerimin e investimeve të bizneseve dhe të familjeve shqiptare, si dhe mbulimin e nevojave të tyre me likuiditet.

## **VI.2. Karakteristikat kryesore të projektbuxhetit 2022 dhe të projektbuxhetit afatmesëm 2022-2024.**

Treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë të projektbuxhetit 2022 janë si më poshtë:

- Rritja reale e PBB 4.1 për qind;
- Inflacioni 2.8 për qind;
- Të ardhurat 28.7 për qind e PBB;
- Shpenzimet 34.1 për qind e PBB;
- Defiçiti buxhetor 5.4 për qind e PBB;
- Borxhi publik 79.4 për qind e PBB;
- Investimet publike 6.4 për qind e PBB;
- Norma e papunësisë 10.3 për qind e PBB.

Shumica e deputetëve vlerësoi se karakteristikat kryesore të projektbuxhetit 2022 janë si më poshtë:

### ***Së pari, rritja e ekonomisë me ritme të qëndrueshme.***

Ekonomia e vendit parashikohet të zgjerohet me ritme të qëndrueshme gjatë vitit 2022 dhe periudhës afatmesme. Rritja ekonomike, pas recensionit të fortë të vitit 2020 prej 4 për qind, parashikohet të rikuperohet ndjeshëm në vitin 2021, duke arritur nivelin 7.6 për qind. Trendi pozitiv i rritjes ekonomike do të vijojë edhe në periudhën afatmesme 2022-2024, me një mesatare prej 4 për qind. Për vitin 2021 rritja ekonomike parashikohet 4.1 për qind, duke u shoqëruar me një rënie të normës së papunësisë nga 11.4 për qind në vitin 2021, në 10.3 për qind në vitin 2022.

Kjo ecuri pritet të mbështetet nga rritja e kërkesës së brendshme, si nëpërmjet rritjes së konsumit, ashtu edhe të investimeve. Rritja e kërkesës së brendshme, veçanërisht e investimeve, do të

reflektohet në rritjen e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht të turizmit, si dhe në rritjen e importeve. Kontributi neto i kërkesës së huaj, në periudhën afatmesme, parashikohet të jetë pozitiv, por më i moderuar se ai i kërkesës së brendshme.

Zgjerimi i kërkesës do të ndihmojë në rritjen e punësimit dhe të pagave dhe në një kthim gradual të inflacionit drejt objektivit, brenda vitit 2022.

### ***Së dyti, rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.***

Një ndër objektivat e projektbuxhetit 2022 është rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit, e cila përbën faktorin kyç për mbajtjen në kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik, si dhe konsolidimin e financave publike.

Risi për vitin e ardhshëm do të sjellë vënia në zbatim e strategjisë afatmesme të mbledhjes së të ardhurave, e cila po përgatitet prej vitesh nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në konsultim me FMN. Kjo strategji synon:

- përmirësimin e politikave tatimore, duke korrigjuar përjashtimet dhe tarifatat joefektive;
- përmirësimin e administrimit tatimor dhe doganor, duke pasur një sistem të lehtë për t'u zbatuar nga tatimpaguesit.

Zbatimi i kësaj strategjie pritet të sjellë zgjerimin e bazës tatimore, reduktimin e informalitetit në ekonomi dhe rritjen e të ardhurave të buxhetit.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2022, parashikohet të arrijnë nivelin 536.8 miliardë lekë, duke u rritur me 38.8 miliardë lekë ose 7.8 pikë përqindje. Këto të ardhura parashikohen të arrijnë nivelin 28.7 për qind të PBB, nga 28.1 për qind e PBB që pritet të jenë në vitin 2021.

Ritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit dhe struktura e tyre, sipas grupeve kryesore, parashikohen si më poshtë:

- *Të ardhurat nga tatimet dhe doganat* përbëjnë rreth 67.2 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 32.5 miliardë lekë ose 9.9 pikë përqindje.
- *Të ardhurat nga fondet speciale* përbëjnë rreth 20.9 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 7 miliardë lekë ose 6.7 pikë përqindje.
- *Të ardhurat nga pushteti vendor* përbëjnë rreth 5.1 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 2.4 miliardë lekë ose 10.3 pikë përqindje.
- *Të ardhurat jotatimore* përbëjnë rreth 4.5 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të rriten me 1.6 miliardë lekë ose 6 pikë përqindje.

- *Të ardhurat nga ndihmat* përbëjnë rreth 2.6 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura parashikohet të reduktohen me 3.4 miliardë lekë ose 19.4 pikë përqindje.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, edhe në periudhën afatmesme, parashikohen të rriten, duke arritur rreth 29 për qind të PBB.

Efektin më të madh në rritjen e të ardhurave parashikohet ta sjellin rritja e PBB, rritja e volumit të importeve, konjunktura e çmimeve ndërkombëtare, përmirësimi i administrimit fiskal dhe thellimi i luftës kundër informalitetit e evazionit fiskal. Rritja ekonomike pritet të sjellë rritje të pagës mesatare, si dhe rritje të numrit të bizneseve dhe të punësuarve në sektorin privat. Këta faktorë, si dhe nxitja e punësimit, pritet të sjellin rritje të të ardhurave të buxhetit.

Politikat tatimore për vitin e ardhshëm dhe periudhën afatmesme synojnë heqjen e disa përjashtimeve dhe normave të reduktuara nga tatimet dhe taksat, në përputhje me rekomandimet e FMN. Këto politika pritet të sjellin reduktimin e shpenzimeve tatimore dhe rritjen e të ardhurave të buxhetit.

Politikat tatimore pasqyrohen në projektligjet e paketës fiskale 2022 dhe parashikojnë përmirësime në ligjet për tatimin mbi të ardhurat, taksat kombëtare, TVSH dhe akcizat. Efekti i këtyre politikave në projektbuxhetin e vitit 2022 është rreth 5.2 miliardë lekë.

Heqja e përjashtimeve dhe normave të reduktuara tatimore do të shoqërohet me masa mbështetëse për shtresat e prekura prej tyre.

### ***Së treti, rritja e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.***

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2022, parashikohen në nivelin 637.7 miliardë lekë, duke u rritur me 19.1 miliardë lekë ose 3.1 pikë përqindje. Këto shpenzime parashikohen të arrijnë nivelin 34.1 për qind të PBB.

Rritja e shpenzimeve sipas grupeve kryesore dhe struktura e tyre parashikohen si më poshtë:

- *Shpenzimet korrente* përbëjnë rreth 79.3 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime parashikohet të rriten me rreth 38.3 miliardë lekë ose 9 pikë përqindje.
- *Shpenzimet kapitale* përbëjnë rreth 18.9 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime parashikohen në nivelin 6.4 për qind të PBB, i cili është pak më i lartë se niveli i vitit 2020 dhe ndjeshëm më i lartë se mesatarja për periudhën 2012-2019.

### **Së katërti, rikthimi drejt konsolidimit fiskal.**

*Deri në vitin 2019*, para se vendi të goditej nga pandemia, financat publike ishin drejt trajektores së konsolidimit fiskal, i cili u reflektua në uljen e deficitit buxhetor nga 5 për qind e PBB në vitin 2013, në 1.9 për qind të PBB në vitin 2019.

*Në vitin 2020*, për të zbutur efektet e dy goditjeve natyrore që pësoi vendi ynë, u ndoqën politika fiskale ekspansioniste. Këto politika synonin ruajtjen e shëndetit publik dhe të jetës së qytetarëve, si dhe mbështetjen financiare për shtresat në nevojë, bizneset etj. Si rrjedhojë, deficitin buxhetor arriti vlerën 6.8 për qind të PBB, ndërsa borxhi publik 76 për qind të PBB (me rritje 10 pikë përqindje nga një vit më parë).

*Gjatë vitit 2021*, përsëri politika fiskale nevojitej të ishte ekspansioniste, për arsye se vendi dhe e gjithë bota ndodhen ende nën efektet e pandemisë. Për të bërë të mundur zbatimin e një politike të tillë, Kuvendi miratoi disa përjashtime nga rregullat fiskale, të parashikuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Këto përjashtime krijojnë mundësinë për një rritje të përkohshme të borxhit publik dhe shtyrje nga viti 2023, në vitin 2024, të detyrimit që balanca primare të ishte jo më e vogël se zero. Ndryshimet në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor ishin të nevojshme për të ruajtur kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve dhe të agjentëve ekonomikë. Kjo mundësoi realizimin e huamarrjes gjatë viteve 2020-2021 dhe zbatimin e politikës fiskale ekspansioniste.

*Gjatë vitit 2022 e në vijim*, vendi do t'i rikthehet politikës së konsolidimit fiskal, për të siguruar ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe rritjen ekonomike të qëndrueshme. Për këtë arsye:

- *deficiti buxhetor* në vitin 2022 parashikohet 5.4 për qind e PBB, nga 6.8 për qind e PBB që pritet të jetë për vitin 2021;
- *balanca primare* parashikohet negative, por me përmirësim dhe do të rikthehet në nivel pozitiv nga viti 2024 e në vijim, siç parashikohet në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor;
- *balanca korrente fiskale* do të vijë duke u rritur, në përputhje me rregullin e artë të buxhetit, që borxhi publik të merret vetëm për të financuar investimet publike.

*Si rrjedhojë, në vitin 2022 borxhi publik* do të kthehet trajektores rënëse, nga 80 për qind e PBB i pritshëm për vitin 2021, në 78.9 për qind e PBB në vitin 2022, duke vijuar rënien graduale drejt nivelit 74.9 për qind të PBB në vitin 2025 dhe 67.9 për qind e PBB në vitin 2028.

### ***Së pesti, mbështetja me përparësi e investimeve publike.***

Rritja e investimeve publike përbën një ndër faktorët më të rëndësishëm për rritjen e produktivitetit të ekonomisë, mbështetjen e biznesit dhe të punësimit, duke sjellë rritje të qëndrueshme ekonomike. Për këtë arsye, mbështetja e investimeve publike është në fokus të projektbuxhetit për vitin 2022 dhe periudhën afatmesme.

Investimet publike për vitin 2022 parashikohen në vlerën 120.4 miliardë lekë dhe përbëjnë 6.4 për qind të PBB, ndërsa për periudhën afatmesme 2023 dhe 2024 parashikohen të qëndrojnë në nivelin mbi 5 për qind të PBB. Këtu përfshihen edhe fondi i rindërtimit në vlerën 20 miliardë lekë, si dhe transfera kapitale për fondin e shpronësimeve prej 1.8 miliardë lekësh.

Në planifikimin e investimeve janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktore për projektet me financim të brendshëm dhe të huaj. Prioritet për vitin 2022 do të vijojnë të përbëjnë projektet në vazhdim.

Peshën më të madhe në investimet publike e ka infrastruktura rrugore kombëtare, me një vlerë prej rreth 24 miliardë lekësh. Projektet për ujësjellës dhe kanalizime do të financohen në masën 14.3 miliardë lekë në vitin 2022 dhe do të përqendrohen kryesisht në financimin e projekteve të nisura në vitet 2020 dhe 2021.

Projekte në fushën e infrastrukturës rrugore dhe të ujësjellës-kanalizimeve do të realizohen edhe nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me një buxhet prej 18.3 miliardë lekësh. Këtu përfshihen projekti në vazhdim të Lumit të Vlorës dhe projektet e mbështetjes së sistemit të furnizimit me ujë në zonat rurale. Me fondet e FSHZH do të realizohen edhe investimet në zonat me potencial turistik dhe Programi “100 fshatrat”.

### ***Së gjashti, mbështetja e shtresave në nevojë.***

Projektbuxheti i vitit 2022 do të vazhdojë mbështetjen e shtresave sociale në nevojë, duke parashikuar që:

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë janë në nivelin 900 milionë lekë;
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar janë 23.5 miliardë lekë ose 1.3 për qind e PBB.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard lekësh ose 0.1 për qind e PBB.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2.2 miliardë lekësh ose 0.1 për qind e PBB.

Për përfituesit e ndihmës ekonomike parashikohet të ndërmerren disa masa mbështetëse, siç janë:

- Rritja me 10 për qind e masës së ndihmës ekonomike për të gjitha familjet përfituese;
- Dyfishimi i ndihmës ekonomike për të gjitha familjet me 2 ose më shumë fëmijë, prej së cilës përfitojnë rreth 15 mijë familje;
- Trefishimi i ndihmës ekonomike për gratë e dhunuara dhe të trafikuar, si dhe fëmijët jetimë nën 18 vjeç.

### ***Së shtati, rritja e mbështetjes financiare të punonjësve në disa sektorë prioritarë.***

Buxheti i vitit 2022 parashikon rritjen e mbështetjes financiare për punonjësit e sektorëve të shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes. Fondi vjetor për rritjen e pagave është planifikuar në shumën 2.4 miliardë lekë dhe parashikon rritjen e pagës për funksion me 6 për qind për punonjësit e këtyre sektorëve. Shpenzimet totale për pagat në administratën publike, të cilat do të mbulohen nga buxheti i vitit 2022, janë planifikuar në masën 90.6 miliardë lekë ose 4.9% e PBB.

### ***Së teti, vazhdimi i mbështetjes për procesin e rindërtimit dhe luftën ndaj pandemisë Covid-19.***

Projektbuxheti parashikon një fond prej 20 miliardë lekësh për procesin e rindërtimit nga tërmeti, duke synuar përfundimin e këtij procesi brenda vitit të ardhshëm.

Për vitet 2022 dhe 2023 janë parashikuar respektivisht 2.7 miliardë lekë dhe 2 miliardë lekë shpenzime për blerjen e vaksinave anti Covid. Shpenzimet e tjera për përballimin e pandemisë Covid-19 parashikohen në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe të FSDKSH, i cili është me rritje të konsiderueshme.

### ***Së nënti, vazhdimi i reformave strukturore në sektorët prioritarë të ekonomisë.***

Projektbuxeti mbështet sektorët prioritarë, si arsimin, shëndetësinë, bujqësinë dhe infrastrukturën, ku vazhdimi i reformave do të krijojë stimuj pozitivë për rritjen ekonomike dhe punësimin.

- *Sektori i arsimit*, në total, do të financohet me një buxhet prej 65.6 miliardë lekësh, i cili përbën 3.51 për qind të PBB. Gjatë vitit të ardhshëm do të vijojë ofrimi i teksteve shkollore falas për nxënësit që ndjekin arsimin bazë, si dhe për nxënësit nga shtresat sociale në nevojë në arsimin e mesëm dhe të lartë. Do të sigurohet shërbimi i transportit dhe do të mbulohen shpenzimet për financimin e tij për nxënësit që kanë vendbanimin mbi 2 km larg nga shkolla, si dhe për mësuesit që punojnë në distancë mbi 5 km nga vendbanimi. Fondi për shërbimin e transportit të nxënësve dhe mësuesve është parashikuar në vlerën 250 milionë lekë. Mbështetje parshikohet edhe për investimet në fushën e teknologjisë së informacionit, laboratorët didaktikë etj.

- *Sektori i shëndetësisë* do të financohet me një buxhet prej 91.3 miliardë lekësh, i cili është 7 miliardë lekë më shumë ose 12.6 pikë përqindje më i lartë se buxheti fillestar 2021. Prioritet për vitin e ardhshëm përbën financimi i procesit të vaksinimit dhe masave për përballimin e pandemisë Covid-19, rritja e investimeve, financimi për herë të parë i kujdesit të syve për fëmijët 4-14 vjeç. Gjatë vitit të ardhshëm do të fillojë investimi në Spitalin Infektiv, do të kryhen rikonstruksionet në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, si dhe në 50 qendra shëndetësore. Do të vazhdojnë investimet për modernizimin e Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, rikonstruksionin e Spitalit të Pediatriisë, modernizimin e Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Gelardinë", rikonstruksionin e Spitalit Rajonal Kukës, rikonstruksionin e Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, si dhe përfundimin e rikonstruksionit të Pediatriisë së Spitalit Rajonal Elbasan.
- *Sektori i bujqësisë* do të financohet me 12.7 miliardë lekë në vitin 2022. Për mbështetjen e këtij sektori, në projektbuxhet parashikohen masat si më poshtë:
  - ✓ Shtesë fondi për skemat e mbështetjes së fermerëve prej 1.25 miliardë lekësh;
  - ✓ Shtesë fondi për skemën e rimbursimit të naftës me 200 milionë lekë;
  - ✓ Fond i bashkëfinancuar me qeverinë gjermane për financimin e projekteve të reja dhe të *start up*-eve, ku buxheti i shtetit do të financojë me 200 milionë lekë, ndërsa qeveria gjermane me 6.8 milionë euro;
  - ✓ Fond garancie sovrane prej 1 miliardë lekësh për mbështetjen e fermerëve.

Këto politika për mbështetjen e fermerëve, së bashku me financimet ekzistuese, arrijnë vlerën totale prej 7.2 miliardë lekësh, e cila përbën financimin më të madh të dhënë ndër vite nga buxheti i shtetit dhe burimet e huaja për fermerin shqiptar, kryesisht grante të IPARD.

- *Sektori i infrastrukturës* do të financohet me një buxhet prej 47.4 miliardë lekësh. Në fushën e infrastrukturës rrugore do të mbështeten ndërtimi i një sërë projektsh me rëndësi kombëtare, rritja e sigurisë rrugore dhe përmirësimi i mirëmbajtjes së tyre. Projektbuxheti mbështet edhe një sërë projektsh për përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, mbështetjen e furnizimit me energji elektrike, përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve urbane, përmirësimin e planifikimit urban, zhvillimin e transportit ajror, detar e hekurudhor, mbështetjen e burimeve natyrore dhe të industrisë.

Projektet kryesore që do të financohen janë:

- ✓ Përfundimi i punimeve në rrugën Kardhiq – Delvinë;
- ✓ Rruga e Arbrit;
- ✓ Ndërtimi i Tunelit të Llogarasë;
- ✓ Ndërtimi i segmentit rrugor Palasë - Dhërmi;

- ✓ Segmenti i Unazës së Jashtme të Tiranës;
- ✓ Ndërtimi i *bypass*-it perëndimor Shkodër;
- ✓ Zgjerimi i segmentit në dalje Elbasan - Përrenjas - Qafë Thanë;
- ✓ Mirëmbajtja e rrugëve nacionale me financim të brendshëm;
- ✓ Krijimi i linjave të reja hekurudhore Tiranë-Durrës dhe Tiranë-Rinas;
- ✓ Portet e Durrësit dhe të Vlorës;
- ✓ Aeroporti i Vlorës dhe i Sarandës.

**Së dhjeti**, reforma e decentralizimit të qeverisjes do të vijojë me përparësi edhe gjatë vitit 2022 dhe periudhës afatmesme, duke synuar përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Shpenzimet për buxhetin vendor, në vitin 2022, parashikohen në nivelin 59.7 miliardë lekë, me një rritje prej 1.7 miliardë lekësh ose 3 pikë përqindje në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit aktual. Këto shpenzime përbëjnë 3.2 për qind të PBB.

Bazë për këtë rritje do të shërbejë, kryesisht, përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave nga qeverisja vendore, të cilat parashikohen të rriten me 1.6 miliardë lekë ose 6 pikë përqindje në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 2021.

Gjatë vitit 2021 do të vijojë reforma për përmirësimin e skemës së financimit të mbetjeve urbane, duke hartuar metodologjinë për standardizimin dhe rritjen e cilësisë së këtij shërbimi.

Gjithashtu, do të vazhdojë dhe konsolidohet më tej reforma në arsimin parashkollor, duke synuar konsolidimin e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive, që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Deputetët e opozitës u shprehën kundër projektbuxhetit si në tërësi, ashtu edhe për të gjitha pjesët përbërëse dhe treguesit e tij.

\* \* \*

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrtoi edhe raportet në parim të komisioneve të tjera të Kuvendit për projektbuxhetin. Në këto raporte theksohet se të gjitha komisionet e kanë miratuar në parim projektbuxhetin me votat pro të shumicës së deputetëve, duke dhënë edhe argumentet përkatëse. Disa komisione kanë paraqitur kërkesa për shtesë shpenzimesh në disa institucione buxhetore. Të gjitha kërkesat për rishikimin e projektbuxhetit do të shqyrtohen nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat gjatë fazës së shqyrtimit nen për nen të tij, për të bërë të mundur mbështetjen e kërkesave më të domosdoshme e prioritare brenda mundësive që paraqet projektbuxheti.



## **VII. Konsultimi publik.**

Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me grupet e interesit, si Shoqatën për Autonomi Vendore dhe Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, si dhe disa drejtues të bashkive në vend, të cilët paraqitën disa kërkesa për ndryshime në projektbuxhet.

Komisioni do ti shqyrtojë ndryshimet e propozuara gjatë fazës nen për nen të projektbuxhetit.

## **VIII. Përfundim.**

Mbështetur në vlerësimet dhe argumentet si më lart, Komisioni për Ekonominë dhe Financat e miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022” me shumicë votash.

### **RELATORET**

**Blerina GJYLAMETI**

**Pranvera RESULAJ**

### **KRYETARI**

**Eduard SHALSI**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 23.11.2021

#### Dokument parlamentar

#### Komision përgjegjës

### R A P O R T

#### PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

*(shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi)*

#### **I. Hyrje.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 23 nëntor 2021, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Procedura e shqyrtimit të projektbuxhetit nen për nen u mbështet në nenet 32-38 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Relatorë, për këtë projektligj, janë znj. Blerina Gjylameti dhe znj. Pranvera Resulaj.

Shqyrtimi nen për nen i projektbuxhetit u zhvillua pas miratimit në parim të tij, në seancën plenare të datës 16 nëntor 2021.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, si dhe drejtues të stafit të kësaj ministrie, të cilët dhanë mendimin e tyre lidhur me propozimet për ndryshime në projektbuxhet, të paraqitura në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

## **II. Diskutimi në Komision.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat u njoh me raportet e komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit, si dhe me disa propozime të institucioneve kushtetuese e të pavarura dhe të shoqërisë civile për projektbuxhetin. Në të gjitha raportet e komisioneve të tjera theksohet se projektbuxheti është miratuar, nen për nen dhe në tërësi, me shumicë votash. Disa komisione kanë propozuar ndryshime në shpenzimet e parashikuara për vitin 2022 për ministrinë dhe institucionet e fushës që ato mbulojnë, duke dhënë edhe argumentet përkatëse.

Mbështetur në analizën e shqyrtimit në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”, raportet e komisioneve të tjera, problematikat e trajtuara në seancat dëgjimore dhe propozimet e shoqërisë civile, Komisioni për Ekonominë dhe Financat përcaktoi disa fusha prioritare, të cilat duhet të mbështeten me një financim më të madh se ai i parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2022. Gjithashtu, Komisioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, analizoi mundësitë që paraqet projektbuxheti i vitit të ardhshëm për të përballuar shtesën e shpenzimeve në fushat prioritare si më poshtë:

- *Së pari*, mbështetja e reformës në drejtësi dhe objektivave të integritimit evropian;
- *Së dyti*, mbështetja për ekonominë dixhitale dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm;
- *Së treti*, mbështetja për sektorin e turizmit, mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane;
- *Së katërti*, mbështetja më e plotë për funksionet e pushtetit vendor;
- *Së pesti*, mbështetja për trashëgiminë kulturore dhe artin.

## **III. Ndryshimet në projektligj.**

Komisioni miratoi disa ndryshime në projektligj, si më poshtë:

### **III.1. Ndryshime në nenet e projektligjit.**

**1. Neni 10** riformulohet, për të pasqyruar ndryshimet e ligjit për buxhetin e vitit 2021 lidhur me emetimin e eurobondit, i cili u miratua pas dërgimit të projektbuxhetit 2022 në Kuvend. Kjo solli ndryshime në disa tregues që lidhen me financimin e deficitit për vitin 2022.

Riformulimi i nenit 10 është si më poshtë:

### **“Neni 10**

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se deficiti i përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 50 000 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth 632 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative, si më poshtë:

- Huamarrje afatgjatë të destinuara për projekte me vlerë rreth 25 002 milionë lekë;
- Huamarrje në formën “mbështetje buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare me vlerë rreth 17 409 milionë lekë;
- Ripagesa të principalit me vlerë rreth - 42 529 milionë lekë;
- Nënua për pushtetin vendor me vlerë rreth 750 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë është rreth 50 251 milionë lekë.

Çdo diferencë, që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme, të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice, akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2021, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila automatikisht, rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.”.

### **2. Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:**

“Në fund të nenit, shtohet një paragraf më këtë përmbajtje:

“Fondi prej 200 milionë lekësh, i parashikuar në programin buxhetor “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përdoret për parafinancimin,

bashkëfinancimin dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të detyrimeve doganore për projektet me financim të huaj. Procedurat e shpërndarjes së këtij fondi përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e shpenzimeve të përcaktuara në nenin 3, si dhe në tabelat 1 dhe 3, që përmenden respektivisht në nenet 11 dhe 15 të këtij ligji.”.

**3. Në nenin 14,** paragrafi i parë riformulohet si më poshtë:

Fondi rezervë prej 2 900 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, si më poshtë:

- a) 2 400 milionë lekë për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme;
- b) 500 milionë lekë për projektin mbi fëmijët dhe rininë.

**4. Neni 13** riformulohet si më poshtë:

“Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Metodologjia e llogaritjes së pagës mujore bruto për institucionet e sistemit të drejtësisë miratohet me vendim të Kuvendit.”

**5. Neni 15** riformulohet si më poshtë:

#### “Neni 15

Transferta e pakushtëzuar, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore paraqitet në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme përdoret nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për programin buxhetor për infrastrukturën vendore dhe rajonale përdoren sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale, për funksionet e reja të transferuara në bashkitë, shpërndahet sipas anekseve 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta.

Fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat.

“Fondi për emergjencat civile, në masën 1000 milionë lekë, akordohet në programin “Emergjencat Civile” të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky fond shpërndahet për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me një formulë, e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Fondi prej 810 milionë lekësh në zërin shpenzime kapitale në programin “Emergjencat Civile” të Ministrisë së Mbrojtjes, përdoret sipas kriterëve në Aneksin nr.6 bashkëlidhur këtij ligji.”.

Fondi për mbetjet urbane në masën 500 milionë lekë akordohet si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore për mbetjet urbane në kolonën “Menaxhimi i mbetjeve”, dhe përdoret/shpërndahet në përputhje me kriteret e vendosura në Aneksin nr.7 bashkëlidhur këtij ligji.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë për financim/bashkëfinancim për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe asaj sportive, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe sportin. Ministri përgjegjës për arsimin dhe sportin nxjerr udhëzime për kriteret, procedurat, afatet për shpalljen e thirrjes dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

#### **6. Neni 18** ndryshohet si më poshtë:

“Tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të PBB-së për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi për vitin 2021, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve, është **41.9% e PBB-së**. Çdo kontratë e re ndjek procedurat dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP-të”.

**7. Neni 19** riformulohet, për të pasqyruar ndryshimet e ligjit për buxhetin e vitit 2021 lidhur me emetimin e eurobondit, i cili u miratua pas dërgimit të projektbuxhetit 2022 në Kuvend. Kjo solli ndryshime në disa tregues që lidhen me financimin e deficitit për vitin 2022.

Riformulimi i nenit 19 është si më poshtë:

#### “Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2022, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 56 503 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 50 632 milionë lekë.
- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 5 871 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 482 492 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi si më poshtë:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 408 452 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të garantur nga qeverisja qendrore 73 390 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 650 milionë lekë.”.

### **III.2. Ndryshime në tabelat e projektligjit.**

**1. Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** bëhet një rialokim i brendshëm: Pakësohet me 600 milionë lekë transferta e FDSKSH në programin “Shërbime të Kujdesit Dytësor” dhe shtohet me të njejtën vlerë transferta e FDSKSH në programin “Shërbime të Kujdesit Parësor”.

**2. Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë** shtohen shpenzimet me 23 milionë lekë, nga të cilat:

- Shtohen shpenzimet korrente me 90 milionë lekë në programin “Mbështetje për burimet natyrore”, për administrimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, si dhe të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera. Nga këto:
  - ✓ 50 milionë lekë janë shtesë në shpenzime personeli;
  - ✓ 40 milionë lekë janë shtesë në shpenzime korrente.
- Pakësohen shpenzimet kapitale me financim të huaj me 67 milionë lekë në programin “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizimet”.

**3. Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit bëhen këto ndryshime:**

- Shtohen shpenzimet e personelit me 20 milionë lekë në programin “Administrimi i pyjeve” për të plotësuar nevojat për fond page për numrin ekzistues të punonjësve;
- Pakësohen me 500 milionë lekë shpenzimet korrente në “Programin për mbrojtjen e mjedisit”, të destinuara për menaxhimin e mbetjeve urbane në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë kosto shtesë nga rritja e standardit të menaxhimit të mbetjeve urbane. Shtohet me të njejtën vlerë transferta e pakushtëzuar sektoriale për mbetjet në tabelën nr.3 të buxhetit vendor sipas bashkive, sipas listës dhe aneksit specifik të paraqitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Reformulohet neni 15 për të pasqyruar këto ndryshime.
- Brenda tavaneve të programeve buxhetore për këtë ministri propozohen ndryshimet si më poshtë:

- Në shpenzimet korrente, pakësohen me 18 milionë lekë shpenzimet në programin “Mbrojtja e Mjedisit” dhe shtohen me të njëjtën vlerë shpenzimet në programin “Zhvillimi i Turizmit”;
- Në shpenzimet kapitale, pakësohen me 40 milionë lekë shpenzimet në programin “Administrimi i Pyjeve” dhe shtohen me të njëjtën vlerë shpenzimet në kapitullin 1 (Investim);
- Në shpenzimet kapitale, në programin “Zhvillimi i Turizmit”, nga kapitulli 3 (kosto lokale) pakësohen 4,5 milion lekë, nga kapitulli 4 (TVSH) pakësohen 15 milionë lekë dhe shtohen në kapitullin 1 (investime) në total 19.5 milionë lekë;
- Në shpenzimet kapitale në programin “Mbrojtja e Mjedisit”, nga kapitulli 3 (kosto lokale) pakësohen 15 milion lekë, nga kapitulli 4 (TVSH) pakësohen 15 milionë lekë, dhe shtohen në kapitullin 1 (investime) në total 30 milionë lekë.

**4. Në Ministrinë e Mbrojtjes bëhen disa rialokime ndërmjet programeve, si më poshtë:**

- Një rialokim i brendshëm midis programeve, prej 650 milionë lekësh. Ky rialokim bëhet për efekt të politikës së rritjes së pagave sipas tabelës më poshtë:



<b>Shtese per shpenzime personeli</b>				
				<i>ne 000/leke</i>
		<b>600</b>	<b>601</b>	<b>600+601</b>
Tit	Emertimi i Institucionit Buxhetor / Programit	Pagat	Kontrib.e Sigurimeve Shoqerore	<b>Efekti total 6 mujor</b>
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	84,625	16,966	101,591
02120	Forcat e Luftimit	197,284	39,551	236,835
02150	Mbeshtetja e Luftimit	144,240	28,918	173,158
09430	Arsimi Ushtarak	77,952	15,628	93,580
07340	Mbeshtetje per Shendetesine	37,348	7,488	44,836
	<b>Ministria e Mbrojtjes</b>	<b>541,449</b>	<b>108,551</b>	<b>650,000</b>
<b>Paksim ne art mallra dhe sherbime</b>				
		<i>ne 000/leke</i>		
		<b>602</b>		
Tit	Emertimi i Institucionit Buxhetor / Programit	Mallra dhe Sherbime		
02120	Forcat e Luftimit	295,000		
02150	Mbeshtetja e Luftimit	295,000		
10910	Emergjencat Civile	60,000		
	<b>Ministria e Mbrojtjes</b>	<b>650,000</b>		

- Pakësohen me 1.2 miliardë lekë shpenzimet në Programin "Forcat e Luftimit" dhe shtohen me të njëjtën vlerë shpenzimet në programin "Emergjencat Civile". Ky fond destinohet për blerjen e flotës së droneve dhe shërbimeve satelitore.

**5. Në Ministrinë e Drejtësisë** shtohen shpenzimet kapitale me 2 milionë lekë për mirëmbajtjen e godinës.

**6. Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë** bëhen këto ndryshime:

- Pakësohet numri i punonjësve me 3 punonjës për SASPAK;
- Shtohen me 200 milionë lekë shpenzimet korrente në Programin “Menaxhimi i Shpenzimeve Doganore” dhe pakësohen me të njëjtën vlerë shpenzimet korrente në programin “Menaxhimi i shpenzimeve publike”;
- Shtohen shpenzimet kapitale me 200 milionë lekë për fondin e mbështetjes së financimeve të huaja.

## **7. Në Ministrinë e Kulturës bëhen këto ndryshime:**

- Në programin “Trashëgimia Kulturore dhe muzetë”, shtohen shpenzimet në zërin “transfertë tek individ” me 100 milionë lekë dhe pakësohen me të njëjtën vlerë shpenzimet në zërin “transfertë e brendshme”. Këto shpenzime janë për bonusin e rijetëzimit;
- Shtohen me 200 milionë lekë shpenzimet kapitale ne programin “Arti dhe Kultura” për veprat e artit në hapësirat publike.

## **8. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme bëhen këto ndryshime:**

- Pakësohet numri i punonjësve me 21 punonjës për SASPAK;
- Pakësohen shpenzimet e personelit me 20 milionë lekë;
- Pakësohen shpenzimet korrente me 2 milionë lekë.

## **9. Në projektbuxhetin e Kuvendit bëhen këto ndryshime:**

- Shtohen 25 punonjës në organikë, të nevojshëm për krijimin e strukturës së Institutit Parlamentar (IP), në kuadër të projektit PACEP, shtesën e numrit të këshilltarëve dhe riorganizimin e strukturës së institucionit.
- Shtohen shpenzimet me 348 milionë lekë, nga të cilat:
  - ✓ Shpenzime personeli 52 milionë lekë, për të përballuar shtesën e numrit të punonjësve (nga të cilat 40 milionë lekë në programin legjislativ dhe 12 milionë lekë në programin administrativ);
  - ✓ shpenzimet korrente 61 milionë lekë, për plotësimin e nevojave të institucionit;
  - ✓ shpenzimet kapitale 235 milionë lekë, për projektin e dixhitalizimit dhe dhomën e serverave.

Këto ndryshime bazohen në kërkesat sipas vendimit nr.2, datë 23.11.2021, të Byrosë së Kuvendit, të paraqitura dhe dakordësuara në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Ndryshimet e detajuara në projektbuxhetin e Kuvendit paraqiten në tabelën bashkëlidhur këtij raporti.

**10. Në Gjykatën Kushtetuese** shtohen shpenzimet kapitale me 15 milionë lekë, nga të cilat 5 milionë lekë për financimin e projektit të digjitalizimit të arkivës së institucionit dhe 10 milionë lekë për rikonstruksionin e godinës.

**11. Në Prokurorinë e Përgjithshme** shtohen 20 punonjës në organikë, pa shtuar shpenzimet. Këta punonjës janë oficerë të Policisë Gjyqësore. Fondet e akorduara për këtë institucion mund të

përballojnë edhe shtesën e 20 oficerëve të policisë gjyqësore OPGJ të planifikuar për vitet 2023 dhe 2024.

**12. Në Shkollën e Magjistraturës, Komisioni propozon:**

- Rishikimin e buxhetit në qershor të vitit 2022, për akomodimin e të gjitha nevojave që lidhen me pagesat e ekspertëve dhe pedagogëve të programeve formuese të Shkollës, si dhe të zërit të transfertës për buxhetet familjare dhe individët.
- Planifikimin e fondeve të nevojshme në zërin e investimeve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit në masën 576 milionë lekë, të cilat do të përdoren për ndërtimin e godinës së Shkollës.

**13. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor** shtohen shpenzimet kapitale me 130 milionë lekë, të cilat do të orientohen drejt dixhitalizimit.

**14. Në Kolegjin e Posaçëm të Apelit** shtohen shpenzimet e personelit me 30 milionë lekë, për të plotësuar nevojat e institucionit. Shtesa e kërkuar për mirëmbajtjen e godinës do të akomodohet në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

**15. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit** shtohen shpenzimet e personelit me 35 milionë lekë, për të garantuar funksionimin normal të institucionit.

**16. Në Strukturën e Posaçme Antikorrupsion** shtohen shpenzimet me 30 milionë lekë, nga të cilat 20 milionë lekë janë shpenzime korrente dhe 10 milionë lekë janë shpenzime kapitale.

**17. Në projektbuxhetin e Presidencës** shtohen shpenzimet kapitale me 10 milionë lekë për financimin e projektit të digjitalizimit të arkivës së këtij institucioni.

**18. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve** shtohen shpenzimet me 89 milionë lekë, nga të cilat:

- 9 milionë lekë janë shpenzime korrente për procesin zgjedhor;
- 80 milionë lekë janë shpenzime kapitale, të nevojshme për dhomën e serverave, pajisje informatike, pajisje për identifikimin elektronik dhe rikonstruksionin e magazinës.

**19. Në projektbuxhetin e Avokatit të Popullit bëhen këto ndryshime:**

- Shtohet 1 punonjës në organikë;
- Shtohen shpenzimet e personelit me 3 milionë lekë;
- Bëhen disa rialokime, si më poshtë:
  - ✓ Shpenzimet korrente pakësohen me 1 milionë lekë dhe shpenzimet e personelit shtohen me të njejtën vlerë;

- ✓ Shpenzimet kapitale shtohen me 2 milionë lekë dhe shpenzimet korrente pakësohen me të njejtën vlerë.

**20. Në projektbuxhetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi** pakësohen shpenzimet korrente me 2 milionë lekë dhe shtohen shpenzimet kapitale me të njejtën vlerë.

**21. Në projektbuxhetin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** shtohen shpenzimet kapitale për vitin 2022 me 5.5 milionë lekë, për realizimin e projektit të regjistrit elektronik të thirrjeve të pakërkuara.

Vlera totale e këtij projekti është 11 milionë lekë dhe diferenca do të parashikohet në investimet e vitit 2023, pasi ky investim parashikohet të kryhet në një periudhë 2-vjeçare.

**22. Në projektbuxhetin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil** bëhen këto ndryshime:

- Shtohen 2 punonjës në organikë;
- Shtohen shpenzimet e personelit me 1 milionë lekë;
- Reduktohen shpenzimet kapitale me 1 milionë lekë.

**23. Në projektbuxhetin e Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit** shtohen shpenzimet me 77 milionë lekë, nga të cilat:

- ✓ Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm (TVSH) 10 milionë lekë;
- ✓ Shpenzimet kapitale me financim të huaj 67 milionë lekë.

**24. Në Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit** shtohen shpenzimet e personelit me 5 milionë lekë, për përballimin e nevojave të institucionit.

**25. Në Komisionin e Prokurimit Publik** shtohen shpenzimet kapitale me 24 milionë lekë, për financimin e projektit të digjitalizimit të ankesave.

**26. Në Akademinë e Shkencave** shtohen shpenzimet korrente me 20 milionë lekë për funksionimin e institucionit.

**27. Në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë** shtohen shpenzimet korrente me 10 milionë lekë për mbështetjen e projekteve kinematografike.

**28. Në Kontrollin e Lartë të Shtetit** shtohen 15 punonjës, si dhe 30 milionë lekë shpenzime personeli për të përballuar shtesën e numrit të punonjësve. Kërkesa për rritjen e pagave të audituesve, në funksion të rritjes së cilësisë së auditimit dhe forcimit të luftës kundër korrupsionit, të rishikohet si pjesë e politikës për rritjen e pagave.

**29. Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit** rialokohen fondet, duke pakësuar me 900 milionë lekë shpenzimet në “Programme zhvillimi” dhe duke shtuar me të njejtën vlerë shpenzimet në programin

“Infrastruktura vendore dhe rajonale”. Ky ndryshim mbështet kërkesën e paraqitur nga bashkitë e vendit, në kuadër të objektivave të zhvillimit të qendrueshëm.

**30. Në Agjensinë për bashkëqeverisjen** bëhen këto ndryshime:

- Shtohen 30 punonjës në organikë;
- Shpenzimet e personelit shtohen më 30 milionë lekë;

Këto ndryshime bëhen për të mbështetur ristrukturimin e institucionit, pas miratimit të legjislacionit të ri.

**31. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAK).**

Me VKM nr.642/2021 është krijuar Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës. Meqenëse kjo Agjenci është krijuar pas dërgimit të projektbuxhetit 2022 në Kuvend, shpenzimet e saj bëhen pjesë e projektbuxhetit.

Projektbuxheti për këtë Agjenci parashikohet si më poshtë:

- Shtohet numri i punonjesve të kësaj Agjencie me 73 vetë dhe pakësohet numri i punonjësve të Këshillit të Ministrave me 10 vetë.
- Shtohen shpenzimet me 200 milionë lekë, nga të cilat:
  - ✓ Shpenzime personeli 80 milionë lekë;
  - ✓ Shpenzime korrente 70 milionë lekë, nga të cilat 50 milionë lekë për mirëmbajtjen e dy sistemeve informatike (EAMIS dhe IPSIS), që sipas VKM kanë kaluar në administrim të Agjencisë;
  - ✓ Shtohen shpenzimet kapitale me 50 milionë lekë, nga të cilat 48 milionë lekë për shërbime konsulence, studime fizibiliteti, shkrim projekt-propozimesh, oponenca projektsh, vlerësim e realizim projektsh, 2 milionë lekë për faqen e Agjencisë dhe investime të tjera;

**32. Për partitë politike,** shtohen shpenzimet me 200 milionë lekë.

**33. Me kërkesë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,** pas diskutimeve në komisione dhe pas konfirmimeve të marra nga autoritetet kontraktore, bëhen disa ndryshime në listën e koncensioneve/PPP, sipas listës bashkëlidhur.

Një prej ndryshimeve është heqja nga lista e koncesionit të kolaudimit të mjeteve të transportit, i cili është një shërbim që kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Gjithashtu, janë bërë disa saktësime në vlerat e koncesioneve për Rrugën e Arbrit, Aeroportin e Sarandës, portin e Vlorës dhe rrugën Milot-Fier. Këto ndryshime sjellin reduktimin e vlerës totale të kontratave të koncesioneve, e cila pas ndryshimeve rezulton 41.9 për qind e PBB, nga 45.6 për qind e PBB e parashikuar në projektligj. Këto ndryshime nuk sjellin asnjë ndryshim në treguesit e buxhetit.

#### **34. Në buxhetin vendor bëhen këto ndryshime:**

- Në tabelën 3, në kolonën “Shtesë nga Kuvendi”:
  - shtohet transferta e pakushtëzuar në disa bashki me 28 milionë lekë, sipas tabelës bashkëlidhur (nga të cilat 23 milionë lekë janë transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme dhe 5 milionë lekë janë transfertë e pakushtëzuar sektoriale për administrimin e pyjeve).
  - shtohet transferta e pakushtëzuar sektoriale për investimet në rrugë me 50 milionë lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.

**Totali i shtesave: 1793 milionë lekë.**

#### **35. Burimet.**

Burimet për mbulimin e shtesës së shpenzimeve buxhetore prej 1793 milionë lekësh do të krijohen nga reduktimi i shpenzimeve në zërat si më poshtë:

1. Fondi për studime e projekttime në Fondin Rezervë 500 milionë lekë;
2. Fondi i projektit *twinning* për universitetet 200 milionë lekë;
3. Fondi i kompensimit të pronave 500 milionë lekë;
4. Fondi i shpronësimeve 593 milionë lekë.

### **III.3. Të gjitha ndryshimet e mësipërme të pasqyrohen në tabelat dhe nenet e projektligjit.**

#### **IV. Rekomandime.**

Pas përfundimit të diskutimit nen për nen të projektligjit, Komisioni paraqiti disa rekomandime për strukturat ekzekutive, si më poshtë:

*Së pari*, disa deputetë theksuan se pjesa më e madhe e detyrimeve të prapambetura të bashkive janë mbartur prej kohës para zbatimit të reformës administrative territoriale në vendin tonë. Duke qenë se stoku i këtyre detyrimeve është i madh dhe pengon realizimin e detyrimeve ligjore të bashkive, Komisioni rekomandon që Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me organet e vetëqeverisjes vendore, të hartojnë plane afatmesme dhe afatgjata, ku të parashikojnë masa dhe afate konkrete për shlyerjen e tyre. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për personat me aftësi të kufizuara.

*Së dyti*, Komisioni ngriti shqetësimin se duhet të rritet efikasiteti i subvencioneve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, në mënyrë që përfitimet të shkojnë tek fermeri dhe të rritet numri i përfituesve. Mbështetje për këtë qëllim duhet të japë krijimi i regjistrit të fermave, i cili duhet të pasqyrojë dhe konsolidojë bazën e të dhënave për sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet të japë informacion periodik pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat për këto çështje.

*Së treti*, strukturat ekzekutive duhet të forcojnë punën për zbatimin me korrektësi të detyrimeve të përcaktuara në kuadrin ligjor për buxhetin dhe të raportojnë në mënyrë periodike në Komisionin për Ekonominë dhe Financat për ecurinë e sektorëve përkatës.

## **V. Përfundim.**

Komisioni e miratoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, nen për nen dhe në tërësi, me shumicë votash, me ndryshimet si më lart.

**RELATORET**

**Blerina GJYLAMETI**

**Pranvera RESULAJ**

**KRYETARI**

**Eduard SHALSI**